



Republika e Kosovës

Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Punëve të Brendshme-Ministarstvo unutrašnjih poslova-Ministry of Internal Affairs

STRATEGJIA E KOMUNIKIT DHE PLANI I VEPRIMIT I MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME 2014-2016

Mars 2014, Prishtinë

Përmbajtja

HYRJE	3
Qëllimi	4
Objektiva strategjike	4
Objektivat specifike:	4
Rolet në komunikim.....	4
PLANI I VEPRIMIT	6
SHTOJCA 1	10
Udhëzime të përgjithshme	10
1. Parimi i transparencës	10
2. Kufizimet ligjore lidhur me informacionin	11
3. Të drejtat e medieve për të kërkuar, pranuar dhe dhënë informacion	11
4. Të drejtat e viktimave dhe dëshmitarëve	11
5. Prezumimi i pafajësisë dhe i së drejtës për proces të rregullt gjyqësor.....	11
6. Parimi i mosdiskriminimit	12
7. Informacioni lidhur me parandalimin e krimit.....	12
8. Reagimi ndaj deklaratave për shpërdorim dhe korrupsion në institucione	12

HYRJE

Përmes Strategjisë për Komunikim dhe Planit të Veprimit 2014-2016 (SK&PV 2014-2016) synohet të fuqizohet bashkëpunimi në mes të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MBP) dhe agjencive ekzekutive vartëse të saj me publikun përmes medieve, si dhe komunikimit të ndërsjellë.

MPB njih të drejtën e qytetarëve për të pasur qasje në të dhënat publike në përputhje me Legjislacionin në fuçi, përkatësisht Ligjin për Qasje në Dokumente Zyrtare dhe Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si dhe të drejtën e medieve për të raportuar mbi çështjet e interesit publik.

Sfida qëndron në zbatimin e suksesshëm të planit të veprimit, gjë që kërkon angazhimin e një rrethi të gjerë të agjencive të MPB-së dhe partnerëve të saj. Më tutje, Strategjia për Komunikim dhe Plani i Veprimit 2014-2016 identifikon mjetet dhe mundësitë e zyrtarëve dhe institucioneve në përçimin e porosive drejt publikut për të siguruar transparencë dhe llogaridhënie.

Ky dokument është vazhdimësi e strategjisë¹ së mëparshme dhe bazohet në legjislacionin që mbulon fushëveprimtarinë e MPB-së dhe agjencive të saj ekzekutive.

Që nga miratimi i strategjisë së parë të komunikimit, zhvillime të reja të kësaj fushe kanë ndodhur në vend:

- Vënia në funksion e zyrës për informim në kuadër të MPB-së;
- Vënia në funksion e zyrës për informim në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike (AKSP);
- Vënia në funksion e zyrës për informim në Inspektoratin Policor të Kosovës (IPK);
- Vënia në funksion e ueb-faqeve zyrtare të MPB-së dhe disa prej agjencive të saj ekzekutive;
- Realizimi i një numri të konsiderueshëm fushatash vetëdijesimi dhe aktivitete të shumta në fushën e komunikimit me publikun.

Kjo strategji mëton ta përmbushë boshllëkun e krijuar me skadimin e strategjisë paraprake të komunikimit, si dhe të standardizojë komunikimin institucional të MPB-së.

MPB dhe agjencitë ekzekutive do të publikojnë të gjitha informatat që nuk rrezikojnë të drejtat e njeriut dhe që nuk bien në kundërshtim me zbatimin e ligjit në përgjithësi.

STRATEGJIA PËR KOMUNIKIM DHE PLANI I VEPRIMIT TË MPB-SË 2014-2016 ËSHTË ZHVILLUAR NË BASHKËPUNIM ME MISIONIN E OSBE-SË NË KOSOVË

¹ Strategjia dhe Plani Gjithëpërfshirës i Komunikimit 2007-2010, mbështetur nga Programi 3SD nga UNDP, Prishtinë.

Qëllimi

Qëllimi i kësaj strategjie është krijimi dhe zbatimi i udhëzimeve për publikimin e informatave të të gjitha agjencive ekzekutive të MPB-së me rëndësi për publikun. Gjithashtu, qëllim i kësaj strategjie është që t'i mundësoj MPB-së dhe agjencive të saj ekzekutive të veprojnë me transparencë të plotë dhe në pajtim me standardet demokratike për të drejtat e njeriut dhe sigurisë publike të njohura ndërkombëtarisht.

Objektiva strategjike

- Ngritja e mbështetjes dhe e besueshmërisë së qytetarëve të Republikës së Kosovës në punën e MPB-së, duke fuqizuar komunikimin e brendshëm dhe të jashtëm gjatë periudhës 2014-2016.

Objektivat specifike:

- Të vihen në funksion zyrat për informim në ato agjenci ekzekutive në të cilat është paraqitur nevoja për komunikim me publikun;
- Të vazhdohet aftësimi profesional i zyrtarëve për informim të MPB-së dhe i agjencive ekzekutive të saj.
- Të strukturohet komunikimi i brendshëm i MPB-së për informim më efikas të publikut;
- Të ofrohet qasje e shpejtë dhe efikase në informatat me interes për publikun;
- Të thellohet komunikimi me qytetarët për të siguruar transparencë dhe llogaridhënie;
- Të realizohen aktivitetet e MPB-së dhe të agjencive të saj ekzekutive në procesin e integritetit Evropian, e që ndërlidhen me fushën e marrëdhënieve me publikun.

Rolet në komunikim

Bashkëpunimi ndërmjet MPB-së dhe agjencive ekzekutive të saj në fushën e komunikimit do bëhet në këtë mënyrë:

- Çështjet që kanë të bëjnë me prezantimin e politikave dhe aktiviteteve politike të MPB-së dhe të agjencive të saj ekzekutive publikohen nga Zyra për Komunikim Publik (ZKP) e MPB-së;
- Çështjet operative policore dhe aktivitetet e Policisë së Kosovës (PK) me interes për publikun, mbulohen nga Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publik (ZIMP) e PK-së;
- Çështjet që kanë të bëjnë me mbikëqyrjen policore dhe aktivitetet e Inspektoratit Policor të Kosovës (IPK), e që janë në interes për publikun, mbulohen nga Zyrtari për Informim i IPK-së;

- Aktivitetet e Akademinë së Kosovës për Siguri Publike (AKSP), që ndërlidhen me trajnimin dhe aftësimin profesional të punonjësve të institucioneve për sigurinë publike, mbulohen nga Zyrtari për Informim i Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Aktivitetet e Akademinë së Kosovës për Siguri Publike (AKSP), që ndërlidhen me zhvillimin dhe funksionalizimin e arsimit të lartë dhe Institutin e Hulumtimit mbulohen nga Zyrtari për Informim i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike (AKSP);
- Aktivitetet e ndërhyrjes në raste emergjente të fatkeqësive që bien nën mandatin e tyre mbulohen nga Zyrtari për Informim i Agjencisë për Menaxhim Emergjent (AME);

Varësisht nga shkalla e fatkeqësisë apo katastrofës natyrore, komunikimi në raste të tilla do të menaxhohet bazuar në direktivat e Planit të Reagimit Kombëtar².

- Në rastet kur ngjarja apo aktiviteti përfshin angazhimin e dy apo më shumë agjencive të MPB-së në fushën e komunikimit, agjencitë përkatëse punojnë së bashku dhe në koordinim me ZKP-në e MPB-së për informimin e publikut;

²Shih ueb-faqen: http://mpb-ks.org/repository/docs/Plani%20Reagimit%20Kombetar_14_01_11.pdf - shikuar më 17.12.2012

PLANI I VEPRIMIT

Objektiva specifike Nr. 1: Të vihen në funksion zyrat për informim në ato agjenci ekzekutive në të cilat është paraqitur nevoja për komunikim me publikun			
#	Veprimi	Institucioni	Koha e zbatimit
1	Krijimi i zyrës për informim në IPK dhe punësimi i personelit (duke përfshirë pajisjet e nevojshme për punë)	IPK	Gjatë vitit 2014
2	Krijimi i zyrës për informim në AME dhe punësimi i personelit	MPB/AME	Gjatë vitit 2014
3	Nxjerrja e Procedurave Standarde të Veprimit (PSV)	IPK/AME/AKSP	Gjatë vitit 2014
4	Trajnimi themelor i personelit	IPK/AME	Gjatë vitit 2014

Objektiva specifike Nr. 2: Të vazhdohet me aftësimin profesional të zyrtarëve për informim të MPB-së dhe i agjencive ekzekutive të saj			
#	Veprimi	Institucioni	Koha e zbatimit
1	Trajnimi i zyrtarëve për informim të sapo punësuar	IPK/AME	IPK/AME Në vazhdimësi
2	Trajnime të avancuara në fushën e komunikimit publik	MPB dhe të gjitha agjencitë	Në vazhdimësi
3	Organizimi dhe pjesëmarrja në tryeza të rumbullakëta në fushën e komunikimit dhe sigurisë në vend dhe rajon – shkëmbimi i përvojave	MPB dhe të gjitha agjencitë	Në vazhdimësi
4	Pjesëmarrja në seminare e konferenca rreth komunikimit dhe fushës së sigurisë publike	MPB dhe të gjitha agjencitë	Në vazhdimësi

Objektiva specifike Nr. 3:

Të strukturohet komunikimi i brendshëm i MPB-së për informim më efikas të publikut

#	Veprimi	Institucioni	Koha e zbatimit
1	Takime informative të drejtpërdrejta të zyrtarëve për informim me personelin përkatës	MPB	Në vazhdimësi
2	Takime të rregullta të zyrave për informim të MPB-së me agjencitë e saj ekzekutive	MPB dhe të gjitha agjencitë	Çdo 3 muaj
3	Azhurnimi i vazhdueshëm i ueb-faqes zyrtare	MPB dhe të gjitha agjencitë	Në vazhdimësi
4	Harmonizimi i veprimeve në mes të dy apo më shumë agjencive në fushën e komunikimit me publikun	MPB dhe të gjitha agjencitë	Në vazhdimësi
5	Shkëmbimi i informatave relevante ndërmjet zyrave për informim të MPB-së dhe agjencive të saj ekzekutive	MPB dhe të gjitha agjencitë	Në vazhdimësi
6	Shkëmbimi i informatave relevante brenda MPB-së dhe çdo agjencie ekzekutive	MPB dhe të gjitha agjencitë	Në vazhdimësi
7	Zhvillimi i hulumtimeve të ndryshme me qëllim të përmirësimit të shërbimeve të komunikimit	MPB dhe të gjitha agjencitë	Në vazhdimësi

Objektiva specifike Nr. 4:

Të ofrohet qasje e shpejtë dhe efikase në informatat me interes për publikun

#	Veprimi	Institucioni	Koha e zbatimit
1	Publikimi i komunikatave për media (nga zyrat përkatëse) për informim të shpejtë lidhur me aktivitetet në interes të publikut	MPB dhe të gjitha agjencitë	Në vazhdimësi dhe sipas nevojës
2	Mbajtja e konferencave të rregullta dhe të jashtëzakonshme për media për informim efikas të publikut	MPB dhe të gjitha agjencitë	Në vazhdimësi dhe sipas nevojës
3	Krijimi dhe mirëmbajtja e profileve zyrtare në rrjetet sociale (Facebook, Twitter, etj)	MPB dhe të gjitha agjencitë	Në vazhdimësi
4	Informim efikas dhe efektiv të personelit të brendshëm	MPB dhe të gjitha agjencitë	Në vazhdimësi
5	Realizimi i fushatave të ndryshme për vetëdijesim dhe i materialeve promovuese	MPB dhe të gjitha agjencitë	Në vazhdimësi
6	Publikimi periodik i revistës “Mbrojtësi” dhe “Integriteti”	PK, IPK dhe së bashku të gjitha agjencitë e MPB-së	Çdo 3 - 6 muaj
7	Publikimi on-line i buletinit	MPB	Çdo muaj

Objektiva specifike Nr. 5:

Të thellohet komunikimi me qytetarët për të siguruar transparencë dhe llogaridhënie

#	Veprimi	Institucioni	Koha e zbatimit
1	Organizimi dhe pjesëmarrja në takime dhe forume të ndryshme me qytetarët dhe shoqërinë civile	MPB dhe të gjitha agjencitë	Në vazhdimësi
2	Organizimi i vizitave dhe aktiviteteve sociale që përfshijnë grupe të ndryshme të komuniteteve	MPB dhe të gjitha agjencitë	Në vazhdimësi
3	Informimi pro-aktiv i qytetarëve me informata relevante për fushën e sigurisë përmes mjeteve bashkëkohore të komunikimit (Facebook, Twitter, ditarë të ndryshëm interneti [blogs], portale të ndryshme, etj).	MPB dhe të gjitha agjencitë	Në vazhdimësi

Objektiva specifike Nr. 6:

Të realizohen aktivitete të MPB-së dhe të agjencive të saj ekzekutive në procesin e integrimi Evropiane, e që ndërlidhen me fushën e marrëdhënieve me publikun

#	Veprimi	Institucioni	Koha e zbatimit
1	Zbatimi i aktiviteteve informuese mbi parandalimin e migrimit ilegal	MPB	Në vazhdimësi
2	Raportimi mbi përmbushjen e detyrave që dalin nga kriteret e BE-së për parandalimin dhe luftimin e krimit të	MPB	Në vazhdimësi
3	Publikimi i realizimit të detyrave me prioritet që ndërlidhen me obligimet që dalin nga procesi i integritit Evropian	MPB dhe agjencitë tjera	Në vazhdimësi
4	Informimi mbi çështjet që ndërlidhen me ri-integrimin e personave të riatdhesuar	MPB	Në vazhdimësi

SHTOJCA 1

Udhëzime të përgjithshme

Bazuar në nenin 125 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ku thuhet se “institucionet e sigurisë vepronë me transparencë të plotë dhe në pajtim me standardet demokratike e me të drejtat e njeriut të njohura ndërkombëtarisht”, si dhe në nenin 40, 41 dhe 42 ku garantohen liria e shprehjes, e drejta e qasjes në dokumente publike dhe liria e medieve;

Sipas nenit 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut, që garanton të drejtën e lirisë së shprehjes dhe informimit;

Sipas nenit 19 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut dhe nenit 19 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, që garantojnë të drejtën e lirisë së shprehjes dhe informimit, si dhe Kodin e Sjelljes të OKB-së për zyrtarët e zbatimit të ligjit, që në nenin 2 të tij kërkohet të respektohen të drejtat dhe dinjiteti i njeriut;

Sipas rregullores Nr. 3/2011 për Shërbimin e Komunikimit Qeveritar me Publikun, si dhe duke njohur se në një shoqëri demokratike, të gjitha institucionet kanë për detyrë t'i ofrojnë informacione publikut dhe ta bëjnë transparente punën e tyre, në mënyrë që ta rrisin besimin e publikut;

Duke njohur se e drejta për të kërkuar, pranuar dhe dhënë informacion ushtrohet përmes medieve, dhe duke njohur rolin që mediet e luajnë në informimin e publikut rreth çështjeve në interes publik dhe në të qenit “kujdestar” i qeverisë;

Miratohet ky udhëzim i Strategjisë për Komunikim dhe Plani i Veprimit të MPB-së 2014 - 2016.

1. Parimi i transparencës

Parim drejtues për MPB-në dhe agjencitë e saj ekzekutive gjatë ofrimit të informacionit për publikun është transparenca.

1.1 Synim i zyrave për informim publik të MPB-së dhe agjencive ekzekutive të saj është që përmes medieve t'i ofrojë publikut informacion të plotë dhe në kohë.

1.2 Të gjitha informacionet që publikohen në medie duhet të jenë në pajtim me legjislacionin për qasje në informacion, udhëzimet e brendshme, Kodin Etik dhe kërkesat tjera në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare.

1.3 Informacioni u ofrohet medieve si në mënyrë pro-aktive ashtu edhe me kërkesë. Ofrimi pro-aktiv i informacionit përfshin njoftimet, komunikatat, fushatat e ndryshme, komunikimin përmes internetit dhe rrjeteve sociale, si dhe konferencat për medie. Gjithashtu, zyrtari për informim

duhet të jetë në dispozicion për t'iu përgjigjur pyetjeve të medieve dhe për t'iu ndihmuar atyre të mbledhin informacione rreth punës së MPB-së dhe agjencive të saj ekzekutive.

2. Kufizimet ligjore lidhur me informacionin

2.1 Të vetmet kufizime në informacionin që MPB-ja, duke përfshirë agjencitë e saj ekzekutive, vë në dispozicion të publikut janë ato që janë legjitime sipas së drejtës vendore e ndërkombëtare, duke përfshirë kufizimet për shkak të sigurisë kombëtare, mbrojtjes së rendit publik dhe reputacionit të të tjerëve.

2.2 Nëse ndonjë informacion nuk është klasifikuar qartë si informacion konfidencial, dhe zyrtari për informim e bën këtë informacion publik, atëherë ai nuk mban përgjegjësi penale për shpërndarjen e atij informacioni.

3. Të drejtat e medieve për të kërkuar, pranuar dhe dhënë informacion

3.1 Gjatë ushtrimit të së drejtës themelore për të kërkuar, pranuar dhe dhënë informacion, medieve u jepet qasje në informacionin e mbajtur nga MPB-ja dhe agjencitë e saj ekzekutive, për aq sa të jetë e lejuar me rregullat ekzistuese të secilës agjenci.

3.2 Zyrtarët për informim njohin detyrën profesionale të gazetarit për të verifikuar informacionin dhe për të kërkuar burime tjera të informacionit. Kërkimi dhe publikimi i informacionit që rrjedhë nga burime alternative, të cilët ndonjëherë mund të jenë në kundërshtim me deklaratat zyrtare, nuk duhet të rezultojë me kurrfarë diskriminimi ndaj gazetarit ose medias në fjalë në kuptim të ofrimit të informacionit në të ardhmen.

3.3 E drejta e gazetarëve për të përdorur dhe për t'i mbrojtur burimet anonime të informacionit respektohet çdoherë nga institucionet në fjalë.

4. Të drejtat e viktimave dhe dëshmitarëve

4.1 Privatësia e viktimave dhe dëshmitarëve të krimit respektohen në të gjitha komunikatat dhe deklaratat zyrtare.

4.2 Mbrojtje e veçantë duhet t'u ofrohet viktimave të krimeve seksuale (dhunim, dhunë në familje, etj.) dhe të miturve.

5. Prezumimi i pafajësisë dhe i së drejtës për proces të rregullt gjyqësor

5.1 E drejta për prezumimin e pafajësisë deri sa të mos dëshmohet fajësia dhe e drejta për proces të rregullt gjyqësor respektohen në të gjitha rrethanat.

5.2 Këto të drejta duhet të pasqyrohen dhe të respektohen në të gjitha informacionet që institucionet u ofrojnë medieve.

6. Parimi i mosdiskriminimit

6.1 Informacioni nga institucionet në fjalë nuk duhet të jetë diskriminues në bazë të racës, përkatësisë etnike, ngjyrës, gjinisë, orientimit seksual, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose çdo mendimi tjetër.

6.2 Duhet pasur kujdes që gjatë ofrimit të informacionit të mos diskriminohen mediet. Në veçanti, nuk duhet të diskriminohen kompanitë e medieeve ose gazetarë të ndryshëm, dhe duhet të sigurohet që të gjitha mediet dhe gazetarët të kenë qasje të barabartë në informacion.

7. Informacioni lidhur me parandalimin e krimit

7.1 Institucionet duhet të jenë transparente dhe pro-aktive gjatë ofrimit të informacionit për media që mund t'i ndihmojë parandalimit dhe zbulimit të krimit. Informacioni i tillë përfshin informacionin e shpërndarë përmes medieeve dhe në mënyra tjera, siç janë broshurat, fletushkat, posterët, spotet televizive dhe radiofonike, etj.

7.2 Institucionet inkurajohen që të bashkëpunojnë me mediet në shpërndarjen e informatave mbi parandalimin e krimit.

8. Reagimi ndaj deklaratave për shpërdorim dhe korrupsion në institucione

8.1 Institucionet sigurohen që publikut t'i jepet informacion sa më i plotë i mundshëm në lidhje me deklaratimet dhe hetimet për shpërdorim dhe korrupsion në këto institucione. Për aq sa të jetë e mundur, ky informacion trajtohet në po të njëjtën mënyrë sikurse informatat tjera.